



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ZALBE I PREDSTAVKI - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.622/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husja Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet Mytaher Haskuka nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa A.nr.622/2025 datë 28.02.2025 e parashtruar nga kandidati për deputet Mytaher Haskuka nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Prizrenit, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 28.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.622/2025, të datës 28.02.2025 të parashtruara nga kandidati për deputet Mytaher Haskuka nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilën thekson se gjatë numërimit të votave në QKN në Prizren nuk është respektuar transparenca, specifikisht kamerat nuk kane fokusuar fletëvotimet, ku si rrjedhojë vëzhguesit nuk kanë pasur mundësi të vëzhgojnë numërimin. Ky problem sipas parashtruesit të ankesës nuk është rregulluar deri në ditën e fundit të numërimit në Prizren. Parashtruesi i ankesës thekson se ankesa bazohet në Rregulloren nr. 16/2024 pika 1 dhe pika 2 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës thekson se pasi që kamerat nuk kanë ekspozuar fletëvotimin, vëzhguesit nuk kanë mundur të verifikojnë numërimin në mënyrë transparente, regjistrimet me kamera tregojnë që fletëvotimet nuk mundë të verifikohen i njëjti ka kërkuar rinumërimin e votave sipas nenit 15 dhe 17 të Rregullores nr. 16/2024.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën ka gjetur se :

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se kandidati për deputet nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Mytaher Haskuka, ka dorëzuar ankesë në PZAP më datën 28.02.2025, ku ka pretenduar se gjatë numërimit të votave në QKN në Komuna Prizren nuk është respektuar transparenca, specifikisht kamerat nuk kanë fokusuar fletëvotimet, ku si rrjedhojë vëzhguesit nuk kanë pasur mundësi të vëzhgojnë numërimin.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ankesa është dorëzuar në PZAP me datë 28.02.2025, ndërsa procesi i numërimit në QKN Prizren është përfunduar më datë 19.02.2025 në ora 17:20, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Mytaher Haskuka, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 i LZP-së, *ku afati për dorëzimin e ankesave lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen*, me shkrim pran PZAP-së brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr. 622/2025 datë 28.02.2025

**Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

